



**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**  
**KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**  
**Drejtoria e Subjekteve Zgjedhore Mbikëqyrjes Financimit dhe Monitorimit**  
**Sektori i Subjekteve Zgjedhore dhe Dekriminalizimit**

Data	
Nr. Prot	

**RELACION**

**VENDIMI**

**PËR SHOYRTIMIN E KËRKESËS SË PARTISË POLITIKE “PARTIA BASHKIMI  
DEMOKRAT SHQIPTAR” PËR REGJISTRIMIN SI SUBJEKT ZGJEDHOR PËR  
ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË TË DATËS 11 MAJ 2025**

**I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN  
NË FUQI**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

Duke vlerësuar nga pikëpamja e objekti që trajton ky projektvendim, vlerësohet nga ana e ligjshmërisë se është në kompetencë të Komisionerit për ta shqyrtuar.

**II. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT**

Presidenti i Republikës, me Dekretin nr. 399, datë 05.12.2024, ka caktuar datën 11 Maj 2025 për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvendin.

“Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar” nëpërmjet Kryetarit, Z. Ylber Valteri, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë që do të zhvillohen më datë 11 Maj 2024.

Bashkëlidhur kërkesës është paraqitur dokumentacioni vijues:

- a) Vërtetimi i lëshuar nga Zyra e Regjistrit të Partive Politike, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, datë 11.02.2025, nëpërmjet të cilit vërtetohet se “Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar”, me iniciale “PBD”, me Kryetar Z. Ylber Valteri, rezulton e regjistruar në dokumentacionin e kësaj Zyre.
- b) Deklarata e angazhimit solemn (Model KQZ-04-02);
- c) Deklarata për hapjen e llogarisë së posaçme bankare të partisë politike (Model KQZ-04-03).

Nga dokumentacioni si më sipër, si dhe nga përmbajtja e kërkesës rezulton se:

- a) Emri zyrtar i partisë është “Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar” me shkronja nistore “PBD”, me adresë Rruga "Mine Peza", Vila nr.4, Tiranë;
- b) Kryetari i partisë është Z. Ylber Valteri, me adresë Rruga "Vace Zela", Nr.48, Tiranë;
- c) Financieri i partisë është Zj. Irena Valteri, me adresë Rruga "Vace Zela", Nr.48, Tiranë;
- ç) Personi përgjegjës për komunikim me KQZ-në është Z. Ylli Subashi, me adresë Rruga "Ferit Xhajko", Pranë Ish Restorant Durrësit, Tiranë;
- d) Specimeni i vulës së partisë është i specifikuar.

Kërkesa e paraqitur nga “Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar”, respekton afatin kohor të parashikuar në pikën 1 të nenit 64, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Dokumentacioni bashkëshoqërues i kërkesës, i paraqitur nga “Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar”, është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenet 64, pika 2 dhe 92/2, pika 2, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

**Licela VELIU** -Drejtorja e Subjekteve Zgjedhore, Mbikëqyrjes Financimit dhe Monitorimit

**Pavlina DOÇAJ** -Drejtorja e Ligjshmërisë

**Majlinda ÇELMETA** -Sekretar i Përgjithshëm (në mungesë dhe me urdhër)